




Pranimi / Dorezuar Punime/Prodato Received / Delivery	28.12.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prof Br Prof Prof No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSTHUK	8547/2022		113



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

**A.nr.1106/2022**

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1106/2022 të datës 07.12.2022 e parashtruar nga ankuesja me adresë Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit/Agjencia për Informim dhe Privatësi, në çështjen juridike "kontestim konkursi" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 28.12.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

**PËRFUNDON** procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.1106/2022 të datës 07.12.2022 e parashtruar nga ankuesja

**A r s y e t i m**

Ankuesja, ka aplikuar në konkursin e jashtëm, për emrin e grupit "Specialistë ligjor" me numër të referencës RN00009583 lidhur me pozitat "Zyrtar i lartë ligjor", dy pozita (2) pranë Divizionit për Certifikim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar, në Agjencinë për Informim dhe Privatësi, për klasën e pozitës Profesional 1. E njëjta me datën 07.12.2022 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 7719/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore kundër shpalljes publike të konkursit me numër të referencës RN00009583 për shkak se është shkelur Ligji Nr.06/06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 08.12.2022, përmes shkresës me numër 7792/2022 ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Agjencia për Informim dhe Privatësi, ndërsa kjo e fundit me datën 16.12.2022, përmes shkresës me numër 8158/2022 ka përcjellë përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokollit 7719/2022 të datës 07.12.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin me numër të referencës RN00009583 të datës 22.07.2022; Njoftimin e datës 07.09.2022 mbi listën e ngushtë; Njoftimin e datës 14.09.2022 mbi listën e ngushtë; Njoftimin e datës 04.11.2022 mbi kandidatin e suksesshëm; Njoftimet përmes sistemit simbnj të datës 19.08.2022, 14.09.2022, 20.10.2022, 04.11.2022, 07.11.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 08.12.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 16.12.2022 nga Agjencia për Informim dhe Privatësi.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara si nga ankuesi ashtu edhe nga organi i punësimit, ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankueses Vitesa Alimusaj-Morina, është bërë i pamundur, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se ankuesja me datën 07.12.2022, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa me datën 15.12.2022, ka parashtruar kërkesën me numër të protokollit 8134/2022, me të cilën ka deklaruar se e tërheq ankesën e datës 07.12.2022 për arsye të angazhimeve profesionale dhe personale. Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të kësaj rrethane, konstaton se kërkesa për tërheqje të ankesës është e drejtë e palës e përcaktuar me dispozitat e nenit 103 paragrafit 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se : *"Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë"*, andaj në këtë kuptim, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka vendosur për përfundim të procedimit administrativ në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30)



ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
**Lënda, A.nr.1106/2022, datë 28.12.2022.**

**Ardita Perçuku-Shyti**

*Ardita Perçuku-Shyti*  
**Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional**

**Arben Mehmeti**

*Arben Mehmeti*  
**Kryetar i Kolegjit**



**Vendimi i dërgohet:**

- *Ankueses;*
- *Drejtorit të Përgjithshëm në Agjencinë për Informim dhe Privatësi;*
- *Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë për Informim dhe Privatësi dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së*

